

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 427 Prot.

Tiranë, më 30.03 2017

VENDIM Nr. 43, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në *zonën me potencial arkeologjik*, në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit *TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Uznovës, Berat KM 146+000 deri KM 148+ 000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit *në zonën me potencial arkeologjik*, në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit *TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Uznovës, Berat KM 146+000 deri KM 148+ 000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Në zonën me potencial arkeologjik, në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit *TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Uznovës, Berat KM 146+000 deri KM 148+ 000, të kryhet gërmimi arkeologjik i shpëtimit sipas Konceptit dhe metodologjisë të miratuar në pikën 1 të këtij vendimi, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur ndërmjet shoqërisë "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, për këtë zonë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**